

Kastrati Hotels & Tower shpk

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 23

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë **Kastrati Hotels & Tower shpk**

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Kastrati Hotels & Tower shpk** (më poshtë Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e performancës dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.6 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



MAZARS
Rr. Emin Duralës, Pali "Bijaloc"
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 90 15
www.mazars.al, info@mazars.al

17 Nëntor 2020

Teit Gjini
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	23,281,733	6,408,222
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	20,997,593	10,005,725
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	38,191,767	14,894,065
Inventarë	7	16,962,222	14,765,198
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	53,905,298	830,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		153,338,613	46,903,210
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	2,106,108,716	2,136,640,885
Totali i aktiveve afatgjatë		2,106,108,716	2,136,640,885
Totali i aktiveve		2,259,447,329	2,183,544,095
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	57,775,349	9,411,138
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	66,924,931	7,507,147
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	12	3,682,016	5,993,090
Detyrime tatimore	13	5,203,035	6,845,403
Parapagime të marra	14	8,819,128	7,489,139
Totali i detyrimeve afatshkurtra		142,404,459	37,245,917
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Provizione	15	17,995,079	24,743,495
Totali i detyrimeve afatgjatë		17,995,079	24,743,495
Totali i detyrimeve		160,399,538	61,989,412
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		2,184,746,764	2,184,746,764
Fitime të mbartura		(63,192,081)	-
Fitimi i ushtrimit		(22,506,892)	(63,192,081)
Totali i kapitalit	16	2,099,047,791	2,121,554,683
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,259,447,329	2,183,544,095

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Kastrati Hotels & Tower shpk
(Vlerat janë në Lek)
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	442,195,425	33,622,010
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	5,341,677	(57,920)
Total të ardhura		447,537,102	33,564,090
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(271,804,621)	(17,030,274)
Lënda e parë, materiale të			
1) konsumueshme	19	(113,039,360)	(6,842,167)
2) Të tjera shpenzime	20	(158,765,261)	(10,188,107)
Shpenzime të personelit	21	(152,739,313)	(17,049,038)
1) Paga dhe shpërblime		(133,873,723)	(15,577,599)
Shpenzime të sigurimeve		(18,865,590)	(1,471,439)
2) shoqërore/shëndetësore			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(36,301,575)	(36,181,516)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(9,198,485)	(26,495,343)
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe			
1) shpenzime të ngjashme		-	
2) Shpenzime të tjera financiare		-	
Fitimi/humbja para tatimit		(22,506,892)	(63,192,081)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		-	
Shpenzimi aktual i tatimit të			
2) shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(22,506,892)	(63,192,081)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(22,506,892)	(63,192,081)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Kastrati Hotels & Tower shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2018				-
Kapitali fillestar	1,000,000			1,000,000
Rritje kapitali ne para	1,515,480,000			1,515,480,000
Rritje kapitali nga transferimi	668,266,764			668,266,764
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin			(63,192,081)	(63,192,081)
				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	2,184,746,764	-	(63,192,081)	2,121,554,683
Transferim në fitime të mbartura		(63,192,081)	63,192,081	-
Fitim I vitit			(22,506,892)	(22,506,892)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	2,184,746,764	(63,192,081)	(22,506,892)	2,099,047,791

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Kastrati Hotels & Tower shpk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

Elsi Keco
Administrator

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	(22,506,892)	(63,192,081)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36,301,575	36,181,516
Shpenzime për provizione	(6,748,416)	24,743,495
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(34,289,570)	(12,528,760)
Rritje/(rënie) në inventar	(2,197,024)	(14,765,198)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(53,075,298)	(830,000)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	103,828,553	29,756,778
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	1,329,989	7,489,139
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	22,642,917	6,854,889
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(5,769,406)	(1,446,667)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(5,769,406)	(1,446,667)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Emetimi i kapitalit fillestar	-	1,000,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	1,000,000
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	16,873,511	6,408,222
Mjetet monetare në fillim të periudhës	6,408,222	
Mjetet monetare në fund të periudhës	23,281,733	6,408,222

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Kastrati Hotels & Tower shpk është një shoqëri e regjistruar më 6 shtator 2018 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqëria ka NIPT L82106038D. Selia e shoqërisë është Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Tiranë. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një vlerë totale 2,184,746,764 LEK i ndarë në 2 kuota. Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Kastrati Group me 80 % pjesëmarrje.
- 2- Fulmer Holding me 20 % pjesëmarrje.

Administrator i shoqërisë është Z. Elsi Keco.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është veprimtari tregtare të import eksportit, të turizmit; administrim e menaxhim hotelerie.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKKP) dhe ligjin nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EURO/ LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit për vitin 2019 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit ne %
Ndërtesa	5%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% .

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	21,251,538	5,655,491
Mjete monetare në arkë	2,030,195	752,731
	23,281,733	6,408,222

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë në dhoma	1,544,194	748,761
Klientë të larguar	19,453,399	9,256,964
	20,997,593	10,005,725

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pala e lidhur Kastrati sha - Kapitali	800,000	800,000
Pala e lidhur Fulmer Holding - Kapitali	-	200,000
AUTO STAR ALBANIA	31,851,568	-
Kastrati Construction	4,757,538	
KST Advertising	697,472	
Kastrati Rezidence	85,189	-
Mak Albania	-	12,679,065
Pala e lidhur Pronari	-	1,215,000
	38,191,767	14,894,065

7. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Ushqime	5,316,588	4,052,170
Pije	5,787,857	5,293,719
Inventar operativ	5,857,777	5,419,309
	16,962,222	14,765,198

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagim per ndertime	49,259,142	-
Parapagim per tatim fitimi	20,000	-
Shpenzime të shtyra	4,626,156	830,000
	53,905,298	830,000

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Toka, troje dhe terrene	Ndërtesa	Te tjera	Totali
Kosto				
Gjendja me 1 Janar 2018				
Shtesa		1,446,667		1,446,667
Transferime	32,231,401	1,887,834,253	251,310,080	2,171,375,734
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	32,231,401	1,889,280,920	251,310,080	2,172,822,401
Shtesa			5,769,406	5,769,406
Transferime				-
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	32,231,401	1,889,280,920	257,079,486	2,178,591,807
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja me 1 Janar 2018				
Amortizimi i vitit		23,616,012	12,565,504	36,181,516
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	23,616,012	12,565,504	36,181,516
Amortizimi i vitit		23,616,012	12,685,563	36,301,575
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	47,232,024	25,251,067	72,483,091
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	32,231,401	1,865,664,908	238,744,576	2,136,640,885
Gjendja më 31 dhjetor 2019	32,231,401	1,842,048,896	231,828,419	2,106,108,716

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë	57,775,349	9,411,138
	57,775,349	9,411,138

11. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme tregtare - MAK Albania	19,116,449	4,545,968
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati shpk	23,605,084	2,961,179
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati sha	3,142,455	-
Llogari të pagueshme tregtare - Autostar Albania	2,576,156	-
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati Residences shpk	2,210,640	-
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati Energy	3,655,312	-
Llogari të pagueshme tregtare - Loxdon shpk	9,012,664	-
Pala e lidhur Pronari	3,606,171	-
	66,924,931	7,507,147

12. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Llogaritë e pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të konstatuara	3,682,016	5,993,090
	3,682,016	5,993,090

13. Detyrime Tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime TVSH	813,852	2,234,467
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,813,161	2,498,473
Detyrime për taksën e fjetjes	577,203	381,150
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	998,819	1,731,313
	5,203,035	6,845,403

14. Parapagime të marra

Detyrimet për parapagimet e marra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagime për evente	8,819,128	7,489,139
	8,819,128	7,489,139

15. Provizione

Provizionet më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Provizione	17,995,079	24,743,495
	17,995,079	24,743,495

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 2,184,746,764 LEK i zotëruar nga ortakët si vijon:

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Kuota	Vlera në para	%	Kuota	Vlera në para	%
Kastrati Group	1	1,747,797,411	80%	1	1,747,797,411	80%
Fulmer Holding	1	436,949,353	20%	1	436,949,353	20%
	2	2,184,746,764	100%	2	2,184,746,764	100%

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga dhomat	214,280,830	10,857,016
Të ardhura nga pijet dhe ushqimi	195,961,578	21,010,802
Të ardhura nga parkimi	-	939,880
Te ardhura nga fitnes	7,187,551	560,383
Te ardhura nga qeraja e dyqaneve	9,843,158	25,820
Te ardhura nga lavanderia	1,560,581	103,261
Te ardhura nga transporti	2,653,840	
Të ardhura të tjera	10,707,887	124,848
	442,195,425	33,622,010

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në		
Qarkullim i tatueshëm	464,589,100	37,898,854
Ushqimi për stafin (pritjet fature dhe nuk deklarohet e ardhur)	(13,294,328)	(2,242,406)
Mallra dhe shërbime të konsumuara nga stafi menaxherial	(8,009,085)	(879,473)
Skontot e aplikuara	(310,564)	(14,090)
Faturim për kreditim të pjesshëm	(779,698)	(1,140,875)
Shuma e qarkullimit të korrigjuar	442,195,425	33,622,010
Sipas Kontabilitetit	442,195,425	33,622,010
Diferenca	-	-

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga rimarrja e provizionit	6,794,162	-
Fitim/ humbja kurse kembimit	(1,452,485)	(57,920)
	5,341,677	(57,920)

19. Lënda e parë, materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kosto e mallrave të shitura	103,375,003	6,120,494
Materiale të konsumueshme	9,664,357	721,673
	113,039,360	6,842,167

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Energji elektrike, uje	43,561,941	2,735,314
Qera	8,071,473	456,834
Shpenzime sigurimi	3,470,000	738,583
Lende djegese	38,310,195	3,038,307
Taksa vendore	7,976,030	-
Konsulenca	5,664,746	-
Mirembajtje IT	7,160,658	299,572
Komisione per prenotime online	5,903,710	-
Mirembajtje per hotelin	15,779,300	679,077
Marketing dhe promocion	1,012,916	97,109
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	2,120,174	76,188
Abonime dhe licensa	1,742,896	258,875
Shpenzime udhetimi	551,936	-
Trajnime	1,241,426	-
Prime sigurimi	897,373	-
Komisione bankare	3,665,362	320,493
Kancelari	2,068,651	105,879
Të tjera shpenzime	9,566,474	1,381,876
	158,765,261	10,188,107

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime paga	133,873,723	15,577,599
Shpenzime per sigurime shoqerore	18,865,590	1,471,439
	152,739,313	17,049,038

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime per personelin	9,198,485	1,751,848
Provizione	-	24,743,495
	9,198,485	26,495,343

23. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	(22,506,892)	(63,192,081)
Total shpenzime të panjohura	11,751,311	25,033,778
Shpenzime per pritje percjellje	58,425	
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	25,050	290,283
Provizione		24,743,495
Shpenzime të tjera	11,667,836	
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(10,755,581)	(38,158,303)
Humbje fiskale e mbartur		
Tatim fitimi @15%	(22,506,892)	(63,192,081)

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
AUTO STAR ALBANIA	31,897,653	2,576,156	-	-
KST Advertising	695,296	-	-	-
Albsig	-	-	-	-
KASTRATI shpk	-	23,605,084	-	2,961,179
KASTRATI SHA	800,000	3,142,455	800,000	4,545,968
Kastrati Construction	4,713,630	-	-	-
KASTRATI GROUP	-	-	-	-
KASTRATI RESIDENCES	85,188	2,210,640	-	-
Mardhenie me ortakun	-	3,606,171	1,215,000	-
FULMER GROUP	-	-	200,000	-
Loxdon shpk	-	9,012,664	-	-
MAK ALBANIA	-	19,116,450	12,679,065	-
KASTRATI ENERGY	-	3,655,312	-	-
	38,191,767	66,924,931	14,894,065	7,507,147

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
AUTO STAR ALBANIA	-	2,446,945	-	-
CONTINENTAL GROUP	-	-	-	-
Albsig	-	2,213,291	70,000	-
KASTRATI shpk	160,402	32,623,595	-	4,398,605
KASTRATI SHA	-	1,722,188	-	4,698,914
Kastrati Construction	90,714	-	72,416	-
KASTRATI GROUP	-	406,976	-	-
KASTRATI RESIDENCES	-	2,594,110	-	-
Loxdon shpk	5,150	7,510,553	-	-
MAK ALBANIA	801,390	15,132,369	465,655	-
KASTRATI ENERGY	-	24,443,928	-	-
	1,057,656	89,093,955	608,071	9,097,519

25. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "gjykimet dhe vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.

Mazars Shpk

Tirana, Albania

Tel. +355 4 2222 889

Tel. +355 4 2278 015

info@mazars.al

Pristina, Kosovo

Tel. +381 38 609 029

infokosovo@mazars.al

www.mazars.al